

**VENDIM**  
**Nr. 182, datë 13.3.2012**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FËMIJË, 2012-2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Veprimit për Fëmijë, 2012-2015, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
  2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore e vendore, të përmendura në tekstin e Planit të Veprimit për Fëmijë, 2012-2015, për zbatimin e këtij vendimi.
  3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për monitorimin e zbatimit të këtij plani veprimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**